



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:175662

Datë: 07.11.2023

Numri i dokumentit: 04884151

C.nr.1815/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.H nga Obiliqi, të cilin e përfaqëson Muharrem Sadiku, avokat në Podujevë, Rruga “Llordi Bajram”, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, sheshi “Nëna Terezë”, numër 36, të cilën e përfaqëson Arsim Shaljani, jurist pranë të paditurës, me objekt të kontestit kompensim dëmi, vlera e kontestit 36,605.00€ pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 23.10.2023, të mbajtur në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 07.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.H nga Obiliqi.
- II. DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, që emër të dëmit material dhe jo material lidhur me lëndimin në punë të datës 23.02.2013, për 70% të përgjegjësisë, paditësin ta dëmshpërblejë në shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 4,900.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej..... 4,900.00€
- Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ..... 8,778.00€
- Për shëmtim .....2,450.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej .....2,044.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej .....2,044.00€

- III. DETYROHET e paditura që prestimet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paditësit t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, dhe atë për dëmin material nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë, 04.07.2013, ndërsa për dëmin jomaterial, nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, 07.11.2023, e deri në pagesën e tërësishme të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.
- IV. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e aprovuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje trupore - fizike shuma prej 700.00€, për frikën e pësuar shuma prej 700.00€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shuma prej 4,622.00€, për shëmtim shuma prej 3,150.00€ dhe në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar shuma prej 476.00€, për përkujdesje të personit të huaj shuma prej 896.00€ dhe për rehabilitimit fizioterapeutik klimatik shuma prej 945.00€, SI E PABAZUAR.
- V. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 3,880.40€ (tremijë e tetëqind e tetëdhjetë euro e dyzet cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

### A r s y e t i m

Paditësi, E.H, nga Obiliqi, përmes përfaqësuesit të tij, me datë 04.07.2013 në këtë gjykatë, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin numër C.nr.1576/13, të datës 18.04.2016, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, ndaj të cilit vendim pala e paditur ka parashtruar ankesë. Gjykata e Apelit, me aktvendimin Ac.nr.2772/16, të datës 13.05.2019, ka aprovuar

ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe vendosje.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në padi, seancat gjyqësore dhe fjalën përfundimtare, ka theksuar se është i punësuar tek e paditura Korporata Energjetike e Kosovës. Me datë 23.02.2013 rreth orës 11:20, gjatë një intervenimi në çatinë e një prej objekteve të Korporatës Energjetike së Kosovës, duke intervenuar për mbylljen e një vrime, paditësi është rrëzuar nga çatia në lartësi prej 6 metrave me ç'rast ka pësuar lëndime trupore. Si pasojë e lëndimeve të pësura paditësit i është dhënë ndihmë mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në Klinikën e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv, prej datës 23.02.2013 deri më 06.03.2013, dhe në Klinikën e Neurologjisë nga data 06.03.2013 deri më 18.03.2013. Mbi bazën e kësaj me padi, përkatësisht me parashtrësën e datës 04.10.2023, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ta detyrojë të paditurën që dëmin e pësuar paditësi nga lëndimi në punë me datë 23.02.2013, për 70% të përgjegjësisë, t'ia kompensoj dhe atë: për dhembjet fizike shumë prej 5,600.00€, për friken e pësuar shumë prej 5,600.00€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë shumë prej 13,440.00€, për shëmtim shumë prej 5,600.00€, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar shumë prej 2,520.00€, për perkujdesje të personit të huaj shumë prej 2,940.00€, dhe rehabilitim fizioterapeutik klimatik shumë prej 945.00€, të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8% nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën e plotë.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë: 156.00€ për përpilim të padisë, 2,974.40€ për përfaqësimin e paditësit nga avokati në seanca gjyqësore, 750.00€ për marrjen e provave me ekspertiza nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë dhe ekspertiza mjekësore.

E paditura, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në seancat gjyqësore, në përgjigje në padi dhe fjalën përfundimtare, ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë e paditësit E.H, për nga baza dhe nga lartësia, me pretendimin se e paditura me asnjë provë nuk mund të mbahet përgjegjëse lidhur me dëmin e shkaktuar paditësit, nga se deri të lëndimi i tij nuk ka ardhur si pasojë e lëshimeve të të paditurës. Ka shtuar se në kohën e shkaktimit të lëndimit paditësit, i njëjti nuk ka qenë i pajisur me asnjë urdhëresë të punës nga e paditura, por ka vazhduar në përgjegjësi të vete punën pa përfillur rrezikun që mund të vije nga ai vend ku ka intervenuar, nga se i njëjti është prijës ekipe dhe ka një përvojë të gjatë tek e paditura. Mbi bazën e kësaj, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi i të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: Kontratën e punës me numër 6....me datë të hyrjes në fuqi 01.03.2014, kartelën e punëtorit me numër 6.... të datës 19.11.2015, fletëparaqitjen e fatkeqësisë në punë me numër 383, Raporti mbi rastin, i përpiluar nga zyrtari policor me numër identifikues 1556, Fletëlëshimi me ekspertizë me numër të amzës 70/2013 i datës 06.03.201, Fletëlëshimi me numër amës 499, i datës 15.04.2013, Fletë drejtimi për shiqim kontrolli me numër të kartonit shëndetësor me numër 6...., i datës 28.04.2013, kërkesa për kompensim të dëmit me numër të pranimit 2580 dhe datë pranimi 24.06.2013, kërkesa për kompensim të dëmit material me numër të pranimit 2609 dhe datë pranimi 26.06.2013, ekspertiza nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë, e datës 07.07.2015, e punuar nga eksperti Hamid Nuredini dhe ekspertiza mjekësore e datës 20.10.2015, punuar nga ekspertët Dr. Sabit Sllamniku – Ortoped, Dr. Shpresa Beqiri Rashiti – Neurologe dhe Dr. Nazmie Musliu – Psikiatër, si dhe ekspertiza mjekësore - rivlerësimi mjekësor nga lëmi i Ortopedisë dhe Psikiatrisë, i datës 20.07.2023 e punuar nga eksperti Dr.Sabit Sllamniku dhe Dr.Shpresa Beqiri Rashiti.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata e Punës me numër 6....me datë të hyrjes në fuqi 01.03.2014 dhe Kartela e punëtorit me numër 6.... të datës 19.11.2015, gjykata ka provuar faktin se paditësi, në kohën e lëndimit në punë, datë 23.02.2013, ka qenë i punësuar tek e paditura, në Divizionin e Prodhimit të Qymyrit, në vendin e punës Prijës i mirëmbajtjes në ndërrim.

Nga fletëparaqitjen e fatkeqësisë në punë me numër 383 dhe nga Raporti mbi rastin, i përpiluar nga zyrtari policor me numër identifikues 1556, gjykata ka provuar faktin se me datë 22.03.2013, ora 11:20, punëmarrësi E.H, deri sa ishte në orar të rregullt të punës, gjatë tentimit të mbylljes së vrimës (kupolës) në kulmin e gardërobës, ka pësuar fatkeqësi në punë, si rezultat i të cilës ka pësuar lëndime trupore.

Gjykata me propozimin e palës paditëse, me qëllim që të vërtetohen lëshimet eventuale të ndërgjyqësve në shkaktimin e aksidentit, ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë.

Eksperti nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë, Hamid Nuredini, në ekspertizën e datës 07.07.2015, si dhe sqarimeve në seanca gjyqësore, ka konstatuar se aksidenti i datës 23.02.2013, ka ndodhur gjatë punës së paditësit, kur i njëjti me kërkesën e punëtorit të tij për të hipur në kulmin e gardërobës për kontrollin e mbylljes së një vrime nga e cila pikonte ujë, ka rrëshqitur dhe ka rënë poshtë në punëtori të ruleve. Në kohën e lëndimit, punëtori ka ndërmarrë vetë zgjidhjen e problemit pa e njoftuar inxhinierin e ndërrimit, i cili nuk ka dhënë urdhër për punë pasi që ka qenë në TML-B në Mirash. Shkaqet e lëndimit në punë janë lëshimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Lëshimet e punëdhënësit janë: mos krijimi i kushteve të punës dhe se në objektin e gardërobës, i cili ishte një katesh dhe me lartësi prej 6 metrash, për ecje mbi mur për skaj kupolave nuk ka pasur asnjë lloj mbrojtje nga rënia. Punëdhënësi mban përgjegjësi pasi që ka qenë i detyruar që të zbatoj masat parandaluese, bazuar në detyrimet dhe parimet e përgjithshme të ligjit të zbatueshëm. Lëshimet e punëmarrësit janë: moskujdesi i duhur gjatë ecjes mbi kulm duke marrë parasysh që nuk ka pasur mbrojtje nga mundësia për të rënë nga lartë. Ka konstatuar se punëdhënësi mban përgjegjësi primare pasi që nuk ka bërë identifikimin e rreziqeve nëpër vendet e punës dhe dhënien e udhëzimeve për rreziqet të cilat lajmërohen nga secili vend i punës, ndërsa punëmarrësi mban përgjegjësi sekondare.

Gjykata, ekspertizën nga mbrojtja dhe siguria në punë e ka pranuar në tërësi si të besueshme, pasi që e njëjta, në vlerësimin e gjykatës, ishte e punuar në mënyrë profesionale dhe e argumentuar, brenda vëllimit të detyrave të dhëna nga gjykata, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Nga Fletë lëshimi me ekspertizë me numër të amzës 70/2013 i datës 06.03.201 dhe Fletë lëshimi me numër amës 499, i datës 15.04.2013, Gjykata ka provuar faktin se paditësi, si pasojë e lëndimit në punë të datës 23.02.2013, kishte kërkuar ndihmë mjekësore, për çka edhe ishte hospitalizuar për periudhën kohore nga data 23.02.2013 deri më 06.03.2013 në Klinikën e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv, ndërsa nga data 06.03.2013 deri më 18.03.2013 në Klinikën e Neurologjisë.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve të paditësit, nga lëndimi i datës 23.02.2013, me propozimin e palës paditëse, Gjykata ka nxjerrë provën me ekspertiza mjekësore, me ekspertë nga lëmi i Ortopedisë-Traumatologjisë, Neurologjisë dhe Psikiatrisë, ndërsa me datë 20.07.2023, nga ekspertët mjekësor nga lëmi i Ortopedisë dhe Neurologjisë, është bërë rivlerësimi mjekësor.

Eksperti i Ortopedisë dhe Traumatologjisë Dr. Sabit Sllamniku, në ekspertizën mjekësore të

datës 20.10.2015 dhe rivlerësimin mjekësore të 20.07.2023, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi, si pasojë e lëndimit në punë, ka pësuar këto lëndime trupore: St post comotio cerebri, St post polytrauma, St post contusio haemorrhagica regio temp.dex., St haemorrhagia subarachnoidalis min i dex., Haemathoma epiduralis reg. T.Dex.(4mm), contusio haemorrhagicae intrapulmonum min. doralis bill et parahillar sin. St post Sy psychoorganicum ac. St post VLC labi oris inf et regio temoralis i dex. Këto lëndim konsiderohen lëndim i rëndë trupor, si pasojë e të cilave paditësi ka pasur dhimbje fizike dhe atë: Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej disa minutave deri në humbjen e vetëdijes, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditëve, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 4 muajve dhe të intensitetit të ulët ka edhe më tej, kohë pas kohe, në rastet e ngarkimeve fizike, ecjeve të gjata, qëndrimin të gjatë në këmbë, ndërrimit të motit, aktiviteteve fizike. Eksperti ka konstatuar se paditësi për shkak të vrragës në pjesën e mesme të buzës së poshtme në madhësi deri në 1 cm, ngritje mbi nivelin e buzës e cila pengon gjatë higjienës, përtypjes si dhe vrragës në anën temporale të djathtë me madhësi 1.5 cm dhe formë vijëzore, ka pësuar shëmtim të shkallës së mesme. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë e nevojshme e në kohëzgjatje prej 12 muaj, dhe atë ndihmë në ushqim, veshmbathje, higjienë, aktivitete ditore të ndryshme, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 12 muaj. Ushqim i pasur me vitamina, proteina, materiale minerale me shumë i pasur se ushqimi i zakonshëm. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimit fizioterapeutik klimatik në kohëzgjatje dy herë nga tri javë brenda dy viteve të para pas lëndimit.

Ekspertja mjekësore nga lëmi i Neurologjisë, Dr. Shpresa Beqiri Rashiti, në ekspertizën e datës 20.10.2015 dhe rivlerësimin e datës 20.07.2023, ka konstatuar se paditësi si pasojë e lëndimit në punë ka pësuar Hemiparesis I sin, Cephalea post trsumatica, ashtu që paditësi me datë 20.07.2023 ka pasur këtë status neurologjik: Asimetri e lehtë e këndit të gojës majtas. ES dhe EP:eutrofike, hipertoni e lehtë spastike majtas, FVM e dobësuar majtas shkalla 4, RMT të sforcuara majtas. Asimetri në përgjigjen plantare majtas. Provat cerebellare: Dizmetri majtas.

Ekspertët, Dr.Sabit Sllamniku – Ortoped Traumatolog dhe Dr.Shpresa Beqiri Rashiti, kanë konstatuar se paditësi si pasojë e lëndimit në punë, lëndim morfologjik i trurit me pasojë të deficitit motorik , kapitull I pika 1.1.2c në shkallën 20%, vështirësi në frymëmarrje gjatë ecjes në përpjetë të lehtë, kapitulli IV pika 2.1.6 në shkallë 5%, bazuar në rregullën e Balthazarit ka

pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 24%.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Nazmije Musliu, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi E.H, si pasojë e lëndimit në punë, ka përjetuar frikë sekondare. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 7 orë, nga momenti i rikthimit të plotë të vetëdijes e shoqëruar nga gjendje ankthi, shqetësime gjatë gjumit, reagime neurotike për shkak të pozitës së detyruar dhe vështirësive të adaptimit me kushtet e imobilizimit mjekësor. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 30 ditëve, ndërsa frikë sekondare të intensitetit të ulët ka edhe në kohën e ekzaminimit.

Gjykata, ekspertizat mjekësore nga lëmi i Ortopedisë – Traumatologjisë, Neurologjisë dhe Psikiatrisë, si dhe rivlerësimin mjekësor të datës 20.07.2023, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në faktet e vërtetuara, gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (LP), Ligjit Nr.2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës dhe Ligjit NR. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), të cilat ligje kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko – detyrimor.

Me nenin 42, paragrafi 1, dhe 2, Mbrojtja e përgjithshme në punë, të LP-së është paracaktuar se” 1. I punësuar ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. Paragrafi 2. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.”

Me nenin 60, paragrafi 1, të LP-së është përcaktuar se “punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së

punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.”

Me nenin 2, paragrafi 1, 2, 7 të Ligjit Nr.2003/19 është përcaktuar se “punëdhënësi është i obliguar të krijoj kushtet për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar për ti mbuluar të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Krijimi i fondit për sigurimin shëndetësor, nga kontributet e punëdhënësve për të gjithë punëmarrësit , i liron punëdhënësit prej obligimeve për bartjen e shpenzimeve. 2.2 Punëdhënësi është i obliguar të organizoi dhe të ndërmerr masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës, mundësitë për të shkuar në vendin e punës. 2.7 Punëdhënësi duhet ta informojë punëmarrësin për rreziqet e punëve të cilat kryhen nga ai/ajo. Punëdhënësi duhet t'i informojë punëmarrësit, të cilët do ti ekspozohen rrezikut të lartë, sa më parë që të jetë e mundshme, rreth rreziqeve dhe masat për mbrojtje në punë për të minimizuar rrezikun. Në rast rreziku të pashmangshëm kërcënues për vete dhe për personat tjerë, punëmarrësit i lejohet për të zbatuar kundër masa të përshtatshme, nëse mbikëqyrësi nuk është aty. Duke patur parasysh trajnimin që është bërë dhe mjetet teknike në dispozicion, punëmarrësit nuk do të pësojnë dëm për akte të tilla, përveç në rastet e neglizhencës flagrante ose sabotimit të qëllimtë. ”

Me nenin 3, paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr.2003/19 është përcaktuar se “punëmarrësi është i obliguar t'i përmbahet masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij/saj dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tij/saj në punë, shfrytëzon në mënyrë të duhur mjetet e sigurisë dhe PPM-në, ato i përdor me kujdes dhe i mban në gjendje funksionale. Punëmarrësit gjithashtu duhet të kenë përgjegjësi për të siguruar mbrojtjen dhe shëndetin e të gjithë personave të ndikuar nga veprimet në punën e tyre. Punëmarrësi duhet menjëherë ta njoftoi punëdhënësin e tij për çdo mangësi, rrezik shëndetësor, defekt ose ndonjë dukuri tjetër e cila mund ta rrezikoi sigurinë e tij/saj ose të të punëmarrësve tjerë.”

Me nenin 136 të LMD-së është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet



pavarësisht nga faji. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.”

Me nenin 137 të LMD-së është përcaktuar se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”

Me dispozitën e nenit 154 të LMD-së është përcaktuar se “dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.”, ndërsa me dispozitën e nenit 155 të ligjit të njëjtë është përcaktuar se “për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.”

Me nenin 176, paragrafi 1, të LMD-së, është përcaktuar se “I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.”

Gjykata, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura dhe gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo sepse nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, provave të administruara, është provuar fakti se me datë 23.02.2013, gjatë një intervenimi në çatinë e një prej objekteve të Korporatës Energjetike së Kosovës, duke intervenuar për mbylljen e një verime, paditësi është rrëzuar nga çatia në lartësi prej 6 metrave me c’rast ka pësuar lëndime trupore. Aksidenti në punë, bazuar në konstatimet e ekspertit nga mbrojtja dhe siguria në punë, është si shkak i lëshimeve të punëdhënësit dhe punëmarrësit, me përgjegjësi primare lëshimet e punëdhënësit dhe përgjegjësi sekondare lëshimet e punëmarrësit. Lëshimet e punëdhënësit janë: mos krijimi i kushteve të punës dhe se në objektin e gardërobës, i cili ishte një katesh dhe me lartësi prej 6 metrash, për ecje mbi mur për skaj kupolave nuk ka pasur asnjë lloj mbrojtje nga rënia. Lëshimet e punëmarrësit janë: moskujdesi i duhur gjatë ecjes mbi kulm duke marrë parasysh që nuk ka pasur mbrojtje nga mundësia për të rënë nga lartë. Punëdhënësi mban përgjegjësi pasi ka qenë i obliguar të zbatojë masat parandaluese për shmangien e rreziqeve ndërsa punëmarrësi mban përgjegjësi për moskujdesin e shëndetit dhe sigurisë së tij gjatë punës.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë, sipas kontributit të pjesëmarrësve në shkaktimin e dëmit, dhe ka vendosur që përgjegjësia të jetë 70% për të paditurën Korporata Energjetike e Kosovës, ndërsa 30% për paditësin E.H, kjo bazuar në nenin 173 dhe 176 të LMD-së, lidhur me nenin 60 të LP-së. Ndarja e përgjegjësive është bërë duke vlerësuar lëshimet e të dy palëve në shkaktimin e aksidentit në punë, të listuara si në ekspertizën nga Mbrojtja dhe Siguria në Punë, si dhe pranimin e përgjegjësive nga pala paditëse në shkallë prej 30%.

Gjykata, gjen se për lëndimet e punëtorit në punë, dëmtuesi – në këtë rast e paditura, përgjigjet sipas përgjegjësive objektive, të parapara me Nenin 136 paragrafi 3 të LMD-së, pavarësisht fajit, ndërsa paditësi, si kontribuues në shkaktimin e dëmit, bazuar në nenin 176 të LMD-së, ka të drejtë në kompensimin e pjesës së dëmit në përpjesëtimisht me kontributin e tij në shkaktimin e incidentit dhe dëmit.

Gjykata, në këtë procedurë, ka provuar faktin se e paditura nuk ka përmbushur obligimet nga neni 42, paragrafi 2, i LP-së, ku është përcaktuar se “Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.” E paditura, nuk ka arritur të provojë me asnjë provë materiale (sipas Nenit 319.1 dhe 322.3 të LPK-së), se ka bërë identifikimin e rreziqeve nëpër vendet e punës dhe dhënien e udhëzimeve për rreziqet të cilat lajmërohen nga secili vend i punës të përcaktuara me nenin 2, paragrafi 2 dhe 7 të Ligjit Nr.2003/19. Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ka respektuar obligimet ligjore të parapara me Ligjin e punës dhe me Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.

Gjykata, mbi bazën e gjendjes faktike të provuar si më lartë dhe dispozitave ligjore të sipërcituara, pas vlerësimit të të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, vlerësimit të ekspertizave mjekësore, dhe kontributin e paditësit mbi shkaktimin e dëmit, miratoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, në vlerën e shpërblimit të dëmit si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shumat e gjykuara paraqesin dëmshpërblim prej 70% të dëmit të pësuar nga paditësi në aksidentin në punë, të datës 23.02.2013

Në emër të dhimbjeve fizike, gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në shumë prej 4,900.00€ në vlerë të 70% të dëmit të pësuar nga lëndimi në punë, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike –

ekspertiza mjekësore nga lëmi i Ortopedisë dhe Traumatologjisë dhe nga lëmi i Neurologjisë, është provuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 23.02.2013, kishte pësuar lëndime të rënda trupore, e që ishin: Hemiparesis I sin, Cephalea post trsumatica, St post comotio cerebri, St post polytrauma, St post contusio haemorrhagica regio temp.dex., St haemorrhagia subarachnoidalis min i dex., Haemathoma epiduralis reg. T.Dex.(4mm), contusio haemorrhagicae intrapulmonum min. doralis bill et parahillar sin. St post Sy psychoorganicum ac. St post VLC labi oris inf et regio temoralis i dex, të cilat lëndime nga ekspertët mjekësor janë vlerësuar si lëndime të rënda trupore. Si shkak i këtyre lëndimeve, paditësi kishte përjetuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej disa minuta, dhimbje fizike me intensitet të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditë, dhimbje fizike me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 4 muaj, ndërsa dhimbje fizike me intensitet të ulët ka edhe në kohën e ekzaminimit fizik, kohë pas kohe, në rastet e ngarkimeve fizike, ecjeve të gjata, qëndrimit të gjatë në këmbë, ndërrimit të motit, aktiviteteve fizike.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 4,900.00€, në vlerë prej 70% të dëmit të pësuar, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza nga lëmi i psikiatrisë është provuar se paditësi, si pasojë e aksidentit në punë dhe lëndimit të datës 23.02.2013, ka përjetuar frikë sekondare të intenzitetit të lartë, frikë sekondare të intenzitetit mesatar dhe frikë sekondare të intenzitetit të ulët. Frikë sekondare të intenzitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 7 ditësh, frikë sekondare të intenzitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 30 ditëve dhe frikë sekondare të intenzitetit të ulët ka përjetuar edhe më tutje, në kohën e ekzaminimit mjekësor.

Në emër të kompensimit për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, gjykata ka caktuar dëmshpërblimin në shumë prej 8,778.00€, në vlerë prej 70% të dëmit të pësuar, duke pasur parasysh moshën e paditësit në kohën e aksidentit dhe shkallën e zvogëlimin të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit si pasojë e lëndimit në punë, zvogëlim ky që sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertëve mjekësor është në shkallë prej 24%.

Në emër të kompensimit lidhur me shëmtimin trupor, gjykata ka caktuar shpërblim në shumë prej 2,450.00€, në vlerë prej 70% të dëmit të pësuar si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza nga lëmi i Ortopedisë - Traumatologjisë, është provuar se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 23.02.2013, ka pësuar shëmtim të shkallës së mesme për shkak të vragës në pjesën e mesme të

buzës së poshtme, me madhësi deri 1 cm, ngritje mbi nivelin e buzës e cila pengon gjatë higjienës, përtypjes si dhe vrugës në anën temporale të djathtë me madhësi 1.5 cm dhe formë vijëzore. Gjykata gjatë caktimit të lartësisë së dëmshpërblimit për dëm jo material për shkak të shëmtimit trupor kishte parasysh shkallën e shëmtimit trupor, dukshmërinë e shëmtimit dhe moshën e paditësit. Paditësi, në kohën e lëndimit trupor ka qenë i moshës rreth 48 vjeç, ka pësuar shëmtim trupor të shkallës së mesme, në vend të dukshëm për personat e tjerë.

Gjykata, vlerëson se shumata e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'i mundësoj paditësit si satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shkallën e shëmtimit trupor. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimi e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë të dëmit jomaterial.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë e kujdes të huaj, ka aprovuar shumata si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, për kundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësit i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar, ka caktuar kompensimin në shumën prej 2,044.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse nga ekspertiza mjekësore është provuar fakti se paditësi, si pasojë e lëndimit të datës 23.02.2013, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, në kohëzgjatje prej 12 muajve.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 2,044.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, nga se nga ekspertiza mjekësore është provuar fakti se paditësi, ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë në kuptim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës dhe veshmbathjes, në kohëzgjatje prej 12 muajve.

Gjykata, ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit që ndërlihet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket ndihmës dhe kujdesit të personit të huaj në shumë prej 896.00€, ushqimit të përforcuar shumë prej 476.00€ dhe shpenzimet e rehabilitimit klimaterik në shumë prej 945.00€, kjo nga se në vlerësimin e gjykatës shumat e gjykuara për kategorinë e kujdesit të personit të huaj dhe ushqim të përforcuar janë në harmoni me qëllimin e kompensimit dhe praktikën gjyqësore për këtë lloj kompensimi. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të rehabilitimit klimaterik paditësi nuk ka provuar shpenzime të krijuara për këtë qëllim. Bazuar në dispozitën e nenit 7 dhe 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, paditësi ka pasur barrën e provës për të provuar këtë shpenzim, i njëjti nuk ka provuar shpenzimet e bëra për këtë kategori të kompensimit.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se paditësit i takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata, për dëmin material fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, 04.07.2013, ndërsa për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 07.11.2023, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të LPK-së dhe Rregulloren për Tarifat e Avokatëve,

ashtu që paditësit i pranohen shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 3,880.40). Shpenzimet e procedurës të njohura të paditësit janë: 156.00€ për përpilim të padisë, 2,974.40€ për përfaqësim të paditësit nga avokati në njëmbëdhjetë seanca, 150.00€ për marrjen e provës me ekspertizë nga lëmi Mbrojtja dhe Siguria në Punë, 300.00€ për marrjen e provës me ekspertizë mjekësore dhe 300€ për marrjen e provës me ekspertizë mjekësore – rivlerësim mjekësor. Shpenzimet e procedurës të njohura në këtë çështje juridike për përpilim të padisë dhe për përfaqësim të paditësit në seancat gjyqësore nga avokati, janë përlogaritur brenda kërkesës së palës paditëse, bazuar në tariforin 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, për vlerat e kontestit mbi 10,000.00€ si dhe nenin 452, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr. 1815/19, me datë 07.11.2023

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.